

**EDUART CAKA
RUDENC RUKA
EDUARD SHEHI**

**FILLESAT E GËRMIMEVE ARKEOLOGJIKE TË SHPËTIMIT
NË SHQIPËRI NGA KËNDVËSHTRIMI I DOKUMENTEVE
ZYRTARE OSMANE: RASTI I KONAKUT TË DURRËSIT**

Abstrakt:

Ballina detare e Durrësit ka pasur një vëmendje të posaçme për sa u përket kërkimeve në fushën e arkeologjisë. Kjo vëmendje i kushtohet më shumë faktit që kjo pjesë e qytetit ka njohur për arsye historike një numër ndryshimesh strukturore të vazhdueshme. Pikërisht në këtë vazhdë kërkimesh kemi pasur mundësinë të marrim në shqyrtim disa dokumente osmane të panjohura më parë. Kështu, në vitin 1881 administrata lokale e Durrësit ka dërguar katër shkresa drejt Ministrisë së Brendshme në Stamboll. Në to njoftoj se gjatë punimeve për ndërtimin e konakut të mytesarifit janë gjetur objekte arkeologjike. Këto objekte u dërguan në kryeqytet për t'u vendosur në Muzeun Perandorak në nëntor të vitit 1882. Artikulli ynë synon të trajtojë në mënyrë të detajuar dhe analitike procesin që çoi në zbulimin e këtyre objekteve dhe evoluimin e qasjes ndaj trashëgimisë antike në territorin shqiptar përgjatë administrimit osman. Në vazhdim do të paraqesim një përmbledhje mbi qasjen e shtetit osman ndaj arkeologjisë dhe në territorin shqiptar gjithashtu, pasuar nga një historik i ndërtimit të fortifikimit osman ku u ngrit më pas Konaku. Do të vijojë një paraqitje e dokumenteve osmane dhe interpretimi i tyre, për t'u mbyllur me konkluzionet.

Fjalë kyçe:

Histori e Arkeologjisë, fortifikimet e Durrësit, Konaku i Durrësit.

Hyrje

Tradita e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri fillon me punën e Qirjakut të Ankonës (Cyriacus Anconitanus), i cili dokumentoi një numër mbishkrimesh përgjatë qendrave antike të bregdetit. Për sa i përket Durrësit, ai dokumentoi të paktën pesë mbishkrime latine gjatë vizitës së

tij në korrik të vitit 1436.¹ Për fat të keq dorëshkrimet e tij origjinale konsiderohen të humbura dhe ajo çka njohim mbijeton falë shënimeve të miqve të Qirjakut.² Një rëndësi të veçantë merr edhe përshkrimi i Marin Barletit në veprën e tij monumentale mbi Skënderbeun, i cili jep të dhëna topografike në lidhje me rrënojat antike të Durrësit.³ Përshkrimi i tij është më i hershmi i identifikuar deri më sot nga këndvështrimi i një vendësi. Ilustrimet më të hershme të objekteve arkeologjike të lidhura me historinë e lashtë të Durrësit, të tilla si monedha antike, paraqiten në hartën e Rigas Feraios të botuar gjatë viteve 1796-1797.⁴ Kjo hartë përmban ilustrimin e dy tipa monedhash, njëra nga të cilat prerje e Mbretit ilir, Monun.

Sidoqoftë, një interes i shtuar do të vihet re duke nisur vetëm nga fillimi i shek. XIX nga një numër autorësh të huaj. Kështu, nisur kryesisht nga vëzhgimet e vëllait të tij konsulli francez në Janinë Fransua Pukvil (François Charles H. L. Pouqueville) në vitin 1807, jep një përshkrim të shkurtër të rrënojave të dukshme.⁵ Përshkrime të ngjashme na jep edhe piktori anglez Eduard Lear (Edward Lear)⁶, i cili më së shumti ka lënë një nga dëshmitë më të hershme me anë të një numri vizatimesh me vlerë në lidhje me rrënojat e Durrësit. Këtu mund të përmendet dokumentimi që i bëri Panajot Aravantinoi në gusht të vitit 1850 mbishkrimit të Teodor Komnenit.⁷ Deri diku të hollësishme janë

¹ Cyriacus Anconitanus, *Epigrammata Reperta per Illyricum*, SL 1700, f. 20-21. Për më tepër shih linkun:

<https://www.digitale-sammlungen.de/de/details/bsb10211610> (Klikuar më 11.10.2022)

² Zana Kamberi, "Archaeological Research and Researchers in Albania", *Bulletin of the Institute of Archaeology*, nr. 30, London: 1993, f. 2.

³ Marinus Barletius, *Vita et res preclare gestae Georgii Castrioti, Epirotarum principis*, Zagrabiae: J. B. Weitz, 1743, f. 365.

⁴ Maria Pazarli, "The Coins Represented in Rigas Charta as a Major Thematic Cartographic Element", *E-Perimtron*, vol. 3, no. 3, 2008, f. 173-182. Shih linkun:

http://www.e-perimtron.org/Vol_3_3/Vol3_3.htm (Klikuar më 11.10.2022)

⁵ François Charles H. L. Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, vol. I, Paris: chez Firmin Didot père et fils, 1826, f. 398.

⁶ Edward Lear, *Journals of a Landscape Painter in Albania, &c*, London: Richard Bentley, 1851, f. 165-168.

⁷ Παναγιώτου Αραβαντινού Παργείου, *Χρονογραφία Της Ηπείρου: Των Τε Ομόρων Ελληνικών Και Ιλλυρικών Χωρών Διατρέχουσα Κατά Σειράν Τα Εν Αυταίς Συμβάντα Από Του Σωτηρίου Έτους Μέχρι Του 1854* (Panagiótou Aravantinoú Pargeíou, *Chronografía Tis Ipeírou: Ton Te Omóron Ellinikón Kai Illyrikón Chorón*

edhe dëshmitë përshkruese të konsullit gjerman në Shkodër, Hann (Johann Georg von Hahn), si edhe dëshmia e konsullit francez të këtushëm Hekart (Hyacinthe Louis Hecquard). I pari, boton për herë të parë mbishkrimin e Teodor Komnenit* si dhe përshkruan murin mbrojtës të Porto Romanos.⁸ Ndërsa i dyti, dëshmon se në vitin 1836 nga hapja e themeleve për ndërtimin e disa shtëpive pranë portave të qytetit, në thellësinë tre metra ishin zbuluar disa varre të cilat përmbanin monedha, njëra nga të cilat besohet se lexonte emrin e Mbretit ilir, Monun. Gjithashtu, ai na jep një përshkrim të disa prej rrënojave antike më të dukshme në qytet dhe përreth, si dhe dokumentoi disa mbishkrime latine të vendosura në muret e qytetit.⁹ Megjithatë, puna më e rëndësishme me fokus historinë dhe arkeologjinë antike është ajo e arkeologëve francezë Leon Hezej (Léon Alexandre Heuzey) dhe Honore Damet (Pierre Jérôme Honoré Daumet), të cilët në kuadër të studimeve në lidhje me luftën civile midis Cezarit dhe Pompeit ngritën siparin e studimeve të një niveli profesional në Shqipëri. Falë punës së tyre në terren gjatë vitit 1861 kemi planimetrinë e parë të qytetit të Durrësit, si dhe një numër përshkrimesh dhe ilustrimesh shumë më të hollësishme sesa ato më të hershme.¹⁰ Nuk mund të mbetet pa u përmendur këtu edhe puna e peshkopit të Beratit, Anthim Aleksudhi, i cili është më së shumti i njohur për zbulimin dhe botimin për herë të parë të kodikëve të Beratit sesa për kontributin e tij në fushën e arkeologjisë. Aleksudhi botoi në mënyrë të ilustruar dy tipa monedhash antike të Durrësit si dhe në diskutimin e tij mbi historinë e qytetit e datoi themelimin e tij në vitin 1080 p.e.s, ose pas shkatërrimit të Trojës.¹¹ Me shumë mundësi këto monedha ishin pjesë e një koleksioni

Diatréchousa Katá Seirán Ta En Aftaís Symvánta Apó Tou Sotiriou Étous Méchri Tou 1854) vol. 1, Αθήναις (Athínais): Σ. Κ. Βλαστού (S. K. Blastou), 1856, f. 62.

* Ndërsa për Aravantinoin e dimë të saktë datën e dokumentimit, nuk mund të themi të njëjtën gjë për Hanin.

⁸ Johann Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, 1-3, Jena: Verlag von Friedrich Mauke, 1854, f. 118-119.

⁹ Hyacinthe Hecquard, *Histoire et Description de La Haute-Albanie Ou Guégarie*, Paris: Chez Arthus-Bertrand, 1858, f. 261-263.

¹⁰ Léon Heuzey and Honoré Daumet, *Mission archéologique de Macédoine*, Paris: Librairie Firmin-Didot et Cie, 1876; Léon Alexandre Heuzey, *Les opérations militaires de Jules César: étudiées sur le terrain par la mission de Macédoine*. Paris: Librairie Hachette et Cie, 1886.

¹¹ Άνθιμος Αλεξούδης, *Σύντομος Ιστορική Περιγραφή Της Ιεράς Μητροπόλεως Βελεγραδών Και Της Υπό Την Πνευματικήν Αυτής Δικαιοδοσίαν Υπαγομένης Χώρας / Νόν Πρώτον Συνταχθείσα Και Ιδίως Αναλώμασιν Εκδοθείσα Υπό Του Μητροπολίτου*

më të gjerë objektesh arkeologjike të krijuara nga ana e tij. Bëhet fjalë për një koleksion, i cili ruhej në Berat dhe konsiderohej "*modeste mais précieuse d'objets antiques*" (modest por i çmuar objektesh antike).¹² Më mirë se cilido këtë periudhë kërkimesh në Durrës e përmbledh përshkrimi i vitit 1877 në lidhje me fatin e mbishkrimit të Teodor Komnenit i arkeologut me famë botërore sër Artur Evans (sir Arthur John Evans): "Në oborrin e Konakut turk, ku vazhdova, më njoftojnë se pa një urdhër të posaçëm nga Porta e Lartë, askush nuk mund të shihte antikitetet e Durrësit ([zyrtari] nënkuptonte muret mesjetare). Mes pisllekut dhe rrënojave shtriheshin dy monumente të bukura të artit helenistik, trupi i një heroi dhe një perëndeshë, të dyja prej madhësie mbinjerëzore; dhe afër shtrihej një pllakë në momentin e thyerjes nga barbari, por copat e së cilës i mblodha dhe i bashkova. Në këtë pllakë ishte një mbishkrim greqisht në vargje jambike, që tregonte se si një princ bizantin ndërtoi një nga kullat e qytetit antik. Kulla në të cilën ishte fiksuar fillimisht ekzistonte ende deri pak kohë më parë, por turqit e kishin rrëzuar atë, besoj, për të gjuajtur një thesar! Pavarësisht apelit tim për mëshirë, nuk mund të shpresoj se mbishkrimi do të mbijetojë gjatë; por gjysma e saj mund të zgjasë edhe pak, pasi është përdorur për të mbështetur një shtyllë prej druri të një verande të çuditshme turke!"¹³

Gjithsesi, asnjë nga punët e sipërpërmendura nuk ka një fokus të posaçëm vetëm për qytetin e Durrësit dhe mbeten përgjithësisht përshkruese në lidhje me gjendjen e përgjithshme të rrënojave apo gjetjeve rastësore. Nga sa mund të vihet re e shkuara e Durrësit është një shqetësim ekskluziv i dijetarëve të huaj, të cilët, krahas funksioneve

*Βελεγραδών Ανθίμου Δ. Αλεξούδη, Εν Κερκύρα: Τυπογραφείον 'Η Ιονία' Αδελφών Κάων, 1868, f.142. (Anthimos D. Alexouidi, *Sýntomos Istorikí Perigráfi Tis Ierás Mitropóleos Velegradón Kai Tis Ypó Tin Pnevmatikín Aftís Dikaiodosían Ypagoménis Chóras / Nýn Próton Syntachtheísa Kai Idíois Analómasin Ekdotheísa Ypó Tou Mitropolitou Velegradón Anthímou D. Alexouídi, Εν Κερκύρα: Τυπογραφείον 'Ι Ιονία' Adelfón Káon)**

¹² Eugene Beurlier, "Satyre En Bronze Trouve à Apollonie", *Bulletin de La Société Nationale Des Antiquaires de France*, Paris: 1885, f. 220-223; Eugene Beurlier, "Monnaie Inédite d'Apollonie", *Bulletin de La Société Nationale Des Antiquaires de France*, Paris: 1885, f. 315-316; Pierre Batiffol, *Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le Codex purpureus 'Φ'*, Paris: Imprimerie nationale, 1896, f. 8.

¹³ Arthur J. Evans, *Illyrian Letters: A Revised Selection of Correspondence from the Illyrian Provinces of Bosnia, Herzegovina, Montenegro, Albania, Dalmatia, Croatia, and Slavonia, Addressed to the Manchester Guardian During the Year 1877*, London: Longmans, Green, and Company, 1878, f. 134-135.

zyrtare dhe interesave të tjerë në lidhje me Shqipërinë, japin edhe informacione të vlefshme sot për kërkimet në këtë qytet. Këto lloj kërkimesh janë të një niveli sipërfaqësor dhe shoqërohen kryesisht me mbledhjen e antikave për të pasuruar koleksionet e kabineteve të kuriozitetit apo dhe muzetë të cilët janë ende në një stad fillestar.¹⁴ Në vazhdim, nisur nga ky historik i shkurtër, mund të thuhet se nuk vërehet asnjë lloj interesimi nga administrata osmane. Një e dhënë e shkëputur nga dorëshkrimi i Kozma Thesprotit mbi gërmimet arkeologjike të kryera me nismën dhe nën tutelën e Ali Pashë Tepelenës në qytetin e Apolonisë, mbetet një rast i kufizuar në krahasim me të gjithë traditën vendëse.¹⁵ Mbase kjo mungesë interesi ndaj së shkuarës nëpërmjet arkeologjisë do të duhet të kërkohet në drejtime të tjera. Kështu, ndërtimi i një biblioteke të pasur nga ana Bushatllinjve në qytetin e Shkodrës mund të jetë një e dhënë domethënëse për të shpjeguar këtë situatë.¹⁶ Në anën tjetër koleksionet e përmendura të familjeve Vlora, Vrioni apo të jezuitëve nuk kanë një historik të qartë në lidhje me fillesat e tyre dhe janë të njohura më shumë nga dëshmi të mëvonshme.¹⁷

Sidoqoftë hartimi dhe miratimi i një numër ligjesh të Perandorisë Osmane gjatë viteve 1869, 1874, 1884 është tregues i një interesi të vonuar rreth kësaj trashëgimie kulturore. Këto ligje vijnë vetëm si pasojë e nevojës për të kontrolluar dhe për të rregulluar situatën e krijuar nga interesi i shtuar i kërkuesve perëndimorë në territorin e Perandorisë Osmane.¹⁸ Vetëm me krijimin e institucionit të Muze-i Hiimayun

¹⁴ Brian M. Fagan and Nadia Durrani, *A Brief History of Archaeology: Classical Times to the Twenty-First Century*, 2nd edition, London, New York: Routledge, 2016, f. 50.

¹⁵ Κοσμάς Θεσπρωτός & Αθανάσιος Ψαλίδας, *Γεωγραφία Αλβανίας Και Ηπειρου: Εξ Ανεκδότου Χειρογράφου Του Κοσμο Θεσπρωτού: Με Τοπογραφικά Σχεδιογραφήματα Και Γεωγραφικούς Χάρτας Του Ιδίου*, Ιωάννινα: Εκδόσεις Εταιρείας Ηπειρωτικών Μελετών, 1964, f. 24. (Kosmās Thesprotós & Athanásios Psalídas, *Geografía Alvanías Kai Ipeirou: Ex Anekdotou Cheiroγράφου Του Kosma Thesprotoú: Με Τοπογραφικά Σχεδιογραφήματα Και Γεωγραφικούς Χάρτας Του Ιδίου*, Ιοάννινα: Εκδόσεις Εταιρείας Ιπειροτικών Μελετών)

¹⁶ Për një dëshmi të kohës në lidhje me këtë bibliotekë, shih David Urquhart, *The Spirit of the East*, vol. II, London: Henry Colburn Publisher, 1839, f. 309-311.

¹⁷ Luigi Maria Ugolini, *Albania Antica: Ricerche Archeologiche*, vol. I, Roma-Milano: S.E.A.I, 1927.

¹⁸ Zeynep Çelik, "Defining Empire's Patrimony: Late Ottoman Perceptions of Antiquities", in *Scramble for the Past. A Story of Archaeology in the Ottoman Empire, 1753-1914*, edited by Zainab Bahrani, Zeynep Çelik and Edhem Eldem, Istanbul: Salt/Garanti Kültür A. S., 2011, f. 443-477.

(Muzeut Perandorak) duket të jetë krijuar një ndërgjegjësime më i gjerë.¹⁹ Nisur pikërisht nga ky ndërgjegjësime mund të kuptohet edhe interesi për skulpturat e zbuluara gjatë gërmimeve për hapjen e themeleve të Konakut të Durrësit.

Shteti osman dhe arkeologjia

Si një perandori e cila përfshiu brenda saj për një periudhë disashekullore hapësira të konsiderueshme të Ballkanit, Europës Qendrore e Lindore, Anadollit, Lindjes së Mesme e Afrikës Veriore, Perandoria Osmane administronte hapësira me një të shkuar të vjetër e të pasur kulturore. Gjatë shek. XIX rëndësia e këtyre territoreve filloi të lidhej edhe me një tjetër faktor, ai i trashëgimisë historike. Lindja dhe zhvillimi i disiplinave të ndryshme të shkencave humane, siç qe ajo e arkeologjisë por edhe i koncepteve të ruajtjes së kësaj trashëgimie që solli lindjen e muzeologjisë, bëri që udhëtarë, diplomatë e studiues të huaj t'i shikonin me syrin e studiuesit hapësirat e kësaj perandorie.²⁰ Paralelisht edhe vetë osmanët filluan të zhvillonin një koncept të evidentimit dhe konservimit të kësaj trashëgime. Këta hapa u konkretizuan me hapjen e disa muzeve në Stamboll gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX.

Origjina osmane e ruajtjes dhe e ekspozimit të objekteve të hershme ka fillesa që nga shek. XV. Historiografia osmane dëshmon aplikimin e kësaj ideje kur Sulltan Mehmedi II vendosi që në kishën e Shën Irenës

¹⁹ Wendy M. K. Shaw, "From Mausoleum to Museum: Resurrecting Antiquity for Ottoman Modernity", in *Scramble for the Past. A Story of Archaeology in the Ottoman Empire, 1753-1914 ...*, f. 423-441.

²⁰ Nga dokumentacioni arkivor mësojmë se qysh në gjysmën e parë të shek. XIX shteti osman ka dhënë leje për kryerjen e gërmimeve brenda hapësirave të veta. Madje, ka raste kur ambasadorë a diplomatë të huaj kanë ndërhyrë për sigurimin e këtyre lejeve. Një prej rasteve më të spikatura në këtë drejtim, është ai i ambasadorit të Britanisë në Stamboll, Canning, i cili kishte lobuar për 3 vjet pranë organeve shtetërore për të siguruar dërgimin drejt Anglisë të dymbëdhjetë copave prej mermeri me figurën e Artemisës. Ali Karaca, "Arşiv Belgelerine Göre Osmanlı İmparatorluğu'nda Arkeoloji Bilinci", *CIEPO: Osmanlı Öncesi ve Osmanlı Uluslararası Komitesi: XIV Sempozyumu Bildirileri*, Ankara: Türk Tarih Kurumu Yayınları, 2004, f. 385-386. Ndërsa për rëndësinë që paraqiste hapësira e Perandorisë Osmane në kuadrin e qasjes arkeologjike, shih Uzi Baram, Lynda Carroll, "The Future of the Ottoman Past, Introducing an Ottoman Archaeology", *A Historical Archaeology of the Ottoman Empire: breaking new Ground*, Ed. Uzi Baram and Lynda Carroll, New York: Kluwer Academic Publishers, 2002, f. 3-5.

(Hagia Eirene) të mblidhte armë e mjete ushtarake, të cilat kishin një vlerë të spikatur ose të tjera që tashmë qenë vjetruar. Kjo praktikë e nisur prej tij u vazhdua edhe prej sulltanëve të tjerë osmanë që pasuan.²¹ Kjo ndërtesë, së cilës iu shtuan gradualisht koleksione private pashallarësh të mëdhenj, mund të konsiderohet si një prototip i muzeut. I tillë do të qëndronte deri në fillimet e shek. XIX për t'u mbyllur në vitet e zhurmshme 1820-1830, që përkohë edhe me shpërbërjen e korpusit të jeniçerëve. I njëjti ambient, këtë herë i konceptuar në frymën e një muzeu të armëve, duke zgjeruar njëkohësisht edhe fondin e koleksioneve, u rifunksionalizua nga Fethi Ahmet Pasha. Ky rast përbën një hap të veçantë në historinë e muzeologjisë osmane, pasi ishte hera e parë kur shteti aprovoi mbledhjen e objekteve të vjetra e me vlerë.²²

Ishte zhvillimi i muzeologjisë në vendet e Europës Perëndimore që u reflektua edhe në Perandorinë Osmane. Studiuesit shprehën se fillimi i krijimit të një mentaliteti osman për muzeologjinë daton në periudhën e Sulltan Abdylmehidit (1839-1861) dhe veçanërisht me figurën e Rodosizade Fethi Ahmet Pashës, i cili kishte shërbyer si ambasador në disa kryeqytete të Europës ku ishte njohur nga afër me zhvillimet në këtë fushë.²³ Praktika dhe përvoja e evropianëve perëndimorë ishte një element kyç në ngritjen e institucionit të parë muzeor brenda perandorisë më 28 janar 1869, Muzeut Perandorak (Müze-i Hümayun). Tre drejtorët e parë të tij ishin evropianë perëndimorë, anglezi Edward Goold (1869-1870), austriaku Terenzio (1870-71) si dhe gjermani Philipp Anton Dethier (1872-1881), i cili mbante gradën e doktorit në fushën e arkeologjisë. Përveç titullarëve të institucionit, arkeologë e ekspertë të huaj u punësuan pranë këtij institucioni. Ata përpiluan rregulloret e administrimit dhe konservimit të objekteve, si dhe klasifikimin, dokumentimin dhe sistemimin e tyre. Në kohën e A. Dethier u përgatit

²¹ Më vonë, ky objekt do të njihej edhe si Muzeu i Armëve të Vjetra ose Muzeu Ushtarak (Mecma-i Asar-i Atika). Për më shumë të dhëna, shih Cenap Çürük, "Askeri Müze", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. III, İstanbul: TDV Yay., 1991, f. 492-493. Kisha në fjalë ndodhej brenda hapësirave që bënin pjesë në rrethimin e sarajit dhe në të qenë vendosur relikte me vlerë shpirtërore për besimtarët ortodoksë, por edhe antikuarë me vlerë që i përkisnin periudhës bizantine. Për më shumë, shih Wendy M. K. Shaw, *Osmanlı Müzeciliği: Müzeler, Arkeoloji ve Tarihin Görselleştirilmesi*, çev. Esin Soğancılar, İstanbul: İletişim Yay., 2014, f. 23-25.

²² W.M.K. Shaw, *Osmanlı Müzeciliği ...*, f. 19.

²³ A. Karaca, "Osmanlı İmparatorluğu'nda Arkeoloji Bilinci...", f. 382.

rregullorja e parë e muzeut, duke i dhënë kështu pamjen e një institucioni të mirëfilltë.²⁴

Fakti që drejtuesit dhe ekspertët ishin shtetas të huaj shfaq më së qarti faktin se Perandoria Osmane kishte mangësi të shumta në këtë drejtim. Me synimin për ta tejkaluar këtë problematikë, osmanët menduan hapjen e një shkolle të veçantë nën institucionin e muzeut, e cila do të kishte për detyrë përgatitjen e kuadrove të rinj në fushën e muzeologjisë. Pas një sërë dekretesh e urdhrash si dhe fondesh të ndara nga ana e qeverisë, Shkolla e Muzeut Perandorak (Müze-i Hümayun Mektebi) nuk arriti të hapej pasi me ndërrimin e drejtorit të muzeut do të ndryshonte edhe strategjia e konceptimit të muzeologjisë. Drejtori i ri që pasoi A. Dethierin, Osman Hamdi Beu, hapi Shkollën e Arteve të Bukura (Sanayi-i Nefise Mektebi) që sot njihet ndryshe edhe si Universiteti i Arteve të Bukura Mimar Sinan.²⁵ Parë nga ky këndvështrim por edhe qasja e re që solli, Osman Hamdi Beu konsiderohet edhe si babai i muzeologjisë osmane.

Këto zhvillime të lidhura me muzeologjinë në shtetin osman ndikuan në qasjen ndaj objekteve të zbuluara nga gërmimet e ndryshme si dhe konservimin e tyre. Vlen të përmendet anëtarësia në një shoqëri të mbrojtjes së veprave me vlerë në Kopenhagen²⁶, kalimi i kompetencave të administrimit dhe të ruajtjes së objekteve të vjetra nga Ministria e Çështjeve Botore te Ministria e Arsimit, si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve osmanë në konferencën botërore të arkeologjisë të mbajtur në Moskë më 1892.²⁷ U realizuan gjithashtu edhe përmirësime në aspektin e rregulloreve që kishin të bënin me gërmimet arkeologjike, me administrimin e objekteve të vjetra që zbuloheshin gjatë hapjes së rrugëve apo ndërhyrjeve urbanistike, si dhe hapa të tjerë që lidheshin me konservimin dhe të drejtën e pronësisë së objekteve që zbuloheshin. Parë

²⁴ Po aty, f. 381-383.

²⁵ Për më shumë të dhëna në lidhje me hapat e ndërmarrë për hapjen e Müze-i Hümayun Mektebi si dhe shkaqet se përse nuk u realizua hapja e saj, shih İbrahim Serbestoğlu, Turan Açıq, "Osmanlı Devleti'nde Modern Bir Okul: Müze-i Hümayun Mektebi", *Akademik Bakış Dergisi*, C. 6, sy. 13, Istanbul: 2013, f. 157-168.

²⁶ Gjatë gjysmës së parë të shek. XIX vërejmë se në vende të ndryshme të Europës janë hapur shoqëri të tilla. Njëra prej këtyre duket se ishte edhe ajo e themeluar në Danimarkë, e cila do të njihej edhe prej Sulltan Abdylazizit, më 8 shkurt 1862. Për detajet, shih A. Karaca, "Osmanlı İmparatorluğu'nda Arkeoloji Bilinci...", f. 382.

²⁷ Për më shumë të dhëna në lidhje me ndryshimet administrative e ligjore që u bënë në këtë drejtim, shih: Po aty, f. 382-383.

nga ky këndvështrim, mund të thuhet se gjatë dy dekadave të fundit të shek. XIX në Perandorinë Osmane tashmë kemi një sistem të mirëfilltë procedural, teknik e infrastrukturor në lidhje me arkeologjinë dhe muzeologjinë.

Një praktikë më e konsoliduar vërehet edhe në fushën e ekspeditave arkeologjike ku, përveç lejeve që u jepeshin arkeologëve të huaj për të realizuar gërmime në hapësira të ndryshme të perandorisë, edhe vetë osmanët ndërmorën aktivitete të ngjashme në vende të pasura me site të vjetra si në Antalia, Izmir, Bagdat, Siri etj. Megjithatë, ata sërish mbeteshin pas krahasuar me aktivitetet e të njëjtit nivel që arkeologë anglezë, francezë e gjermanë kryenin në Siri, Egjipt, Greqi apo vende të ndryshme të perandorisë. Kjo vërehet në përpjekjet e nivelit shtetëror të ndërmarra me synimin e kthimit në vend të veprave apo objekteve të trafikuar jashtë prej arkeologëve të ndryshëm perëndimorë, ashtu edhe nga qasja e shtetit karshi konservimit të këtyre objekteve ku duket se tendenca ishte ruajtja e atyre më kryesoreve ose të tjerave me vlerë monetare. Një shembull ilustrues i kësaj politike duket se është një kërkesë e konsullit amerikan në Qipro, i cili kërkonte në vitet 1868 leje për të dërguar jashtë disa objekte të gjetura gjatë hapjes së hekurudhës Izmir-Ajdin më 1863. E njëjta kërkesë do të bëhej edhe në vitin 1886 dhe, në vendimin e nxjerrë nga Abdylhamiti II në lidhje me këtë çështje urdhërohet që objektet në fjalë të vlerësoheshin prej ekspertëve të muzeologjisë dhe më pas “ato të pavlefshmet” t’u jepeshin amerikanëve për t’i marrë.²⁸

Të gjitha këto që u thanë më sipër nxjerrin në pah disa aspekte të rëndësishme që na ndihmojnë të kuptojmë gjendjen e arkeologjisë dhe të muzeologjisë në Perandorinë Osmane, si dhe qasjen që vetë shteti tregonte në lidhje me këtë çështje gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Më saktësisht, nisur nga trashëgimia e madhe arkeologjike që zotëronte shteti osman në hapësirat e veta territoriale, duket se shek. XIX përkon me një periudhë përgjatë së cilës pati shumë përpjekje të diplomatëve dhe arkeologëve të huaj për të marrë leje gërmimesh në vendgjetje arkeologjike, si dhe për të transportuar jashtë objektet me vlerë që gjenin këtu. Duke kuptuar vlerën që kishte kjo fushë e re, duket se edhe osmanët janë “zgjuar” duke u përpjekur të ngrenë një sistem të evidentimit, administrimit dhe konservimit të kësaj trashëgimie kulturore e materiale.

²⁸ Po aty, f. 387.

Kështu, sado që ndërtimi i muzeve apo institucioneve e procedurave përkatëse që lidhen me muzeologjinë dhe arkeologjinë nisin aty nga fillimi i viteve 1840, i gjithë ky proces është kthyer në një sistem që funksiononte në mënyrë të suksesshme vetëm në vitet 1880.

Ndërtimi i Konakut

Menjëherë pas pushtimit të qytetit janë ndërmarrë punime fortifikuese, të dokumentuara edhe nga burimet arkivore.²⁹ Këto ndërhyrje kanë qenë të kufizuara në qëllimet e tyre, me synimin për të zvogëluar perimetrin e fortifikimeve me afro 1/3 e tyre, duke u përqendruar te hapësira më jugore, pranë portit. Fazat ndërtimore të fortifikimeve osmane i kemi përshkruar më herët,³⁰ prandaj këtu po përqendrohemi vetëm mbi ndërtimet e lidhura me temën që po trajtojmë.

Analiza e mëparshme nga ana jonë e dokumenteve të mësipërme ka dëshmuar se pas vitit 1501 dhe *antequem* 1565 mund të jetë ndërtuar një kullë më e hershme sesa kulla rrethore JP-1 (ish kulla A)³¹, në të njëjtin vend. Në vitin 1565 (ose 1566) është ndërtuar/rindërtuar/përforcuar bastioni L-1 (ish- bastioni Q) dhe duhet të jetë riparuar kulla pararendëse e JP-1. Pas sulmit të vitit 1571 janë ndërmarrë punime ndërtimore / riparuese / fortifikuese në të gjithë ballinën bregdetare të kalasë. Në këtë kohë duhet të jetë ndërtuar *exnovo* faza e parë e bastionit JL-5, duke u datuar *post quem* 1571 dhe *ante quem* 1606. Bastioni, i cili është më i përparuar nga kurtina në drejtim të detit, kishte planimetri në formën e shkronjës U, me gjatësi të ballinës 21 m, gjerësi 1.20 m, me kënde të kthyer në 45°. Themeli, ishte i thellë 0.75 m dhe nuk kishte dallim nga muri, i cili ishte i ndërtuar me gurë të përmasave e llojeve të ndryshme, me pak elemente të ripërdorura, të lidhura me llaç. Ky bastion ka qenë i pajisur me tri frëngji ballore dhe me nga një frëngji te këndet e prera në

²⁹ *I diarii di Marino Sanuto*, vol. IV, Venezia: 1880 kol. 170.

³⁰ Eduard Shehi, "Evoluimi i linjës juglindore të fortifikimeve të Durrësit dhe datimi i 'Torrës veneciane'", *Monumentet*, nr. 59, Tiranë: 2020, f. 92-97.

³¹ Së fundmi Shehi 2022, Topografia e Durrësit mesjetar [*në botim*] ka rikrijuar sistemin e emërtimit të kullave, në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirës dhe sistem i hapur, ku mund të shtohen gjetje të reja pa qenë nevoja e deformimit të tërësisë së kodifikimit të të gjitha elementeve përbërëse të fortifikimeve të Durrësit. Duke qenë se në botimet tona të mëparshme kemi përdorur sistemin e L. Rey, po i vendosim emërtimet e vjetra në kllapa.

45°. Cilësia e realizimit të murit ishte e dobët dhe vëreheshin luhatje në lartësinë e tij. Qëllimi i ndërtimit të tij ishte mbrojtja e Portës së Detit dhe të fortifikimeve mesjetare, të cilat ishin shumë të ekspozuara ndaj goditjeve me artileri nga anijet. Në versionin mesjetar mendojmë se ishte një portë e vendosur pothuaj në mesin e kurtinës, e mbrojtur vetëm nga kullat anësore.³² Me ndërtimin e bastionit hyrja merrte një karakter të mbrojtur, pasi jo vetëm goditja ndaj saj nuk mund të realizohej më drejtpërdrejt, por edhe paraprihej nga një hyrje anësore, që vendosej në mes të krahut lindor të bastionit dhe murit të kurtinës.

Deri në vitin 1606 nuk kemi ende të dhëna dokumentare ose arkeologjike për ndërtime të tjera në linjën fortifikuese në përgjithësi dhe atë juglindore në veçanti. Më 4 gusht 1606, Durrësi është djegur dhe shkrumbuar shumë rëndë pas plaçkitjes nga spanjollët e Napolit.³³ Kjo ngjarje, duhet të ketë shërbyer si kampanë alarmi për osmanët, të cilët jo vetëm kanë qenë të detyruar ta ndërtojnë përsëri Durrësin, por edhe kanë realizuar ndërhyrje të fuqishme mbrojtëse. Një rindërtim nga ana osmane pas plaçkitjes së vitit 1606 përmendet nga D. Farlati e J. Coleti.³⁴ Qëllimi i ndërtimeve mbrojtëse në këtë fazë lidhet me fuqizimin e mureve, që të përballonin goditjet e kundërshtarit, si edhe me shtimin e fuqisë goditëse të artillerisë osmane përgjatë bregdetit jugor, përballë qytetit. Elementi bazë i kësaj faze është ndërtimi i trinomit: kullë rrethore JP-1 – fuqizimi i bastionit JL-5 (ish bastioni S) – fuqizimi i bastionit L-1. Te bastioni JP-5 është bërë në pjesën e jashtme faza e dytë e ndërtimeve, duke krijuar kështu një strukturë të fuqishme, me mure të gjera dhe të qëndrueshme. Ndërtimi i ri u vendos pothuaj ngjitur me fazën e parë, duke ruajtur të njëjtën planimetri, me gjatësi balline 27 m. Themeli ishte cilësisht i dobët, me lartësi 0.77 m. Materiali ndërtimor ishte me gurë të llojeve të

³² E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore të fortifikimeve të Durrësit...”, f. 90-91.

³³ *Arkivi i Simancas*, Estado Leg. 1103, nr. 150, “Relacion i markezit Santa Cruz për Filipin III”, Otranto, 7 gusht 1606; Miguel de Castro, A. Paz y Mélia, *Vida del soldado español Miguel de Castro (1593-1611)*, Barcelona - Madrid: L’Avenç-Libreria de M.Murillo, 1900, f. 29-31; Peter Bartl, 1974 *Wer Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich: Zur Türkenkriegs problematik an der Wende vom 16. zum 17. Jahrhundert*, Wiesbaden: Harrassowitz in Komm., 1974, f. 41; Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: Onufri, 2016, f. 798.

³⁴ Daniele Farlati, Jacobo Coleti, *Illyrici sacri. Tomus VII. Ecclesia Diocletana, Antibarensis, Dyrrhachiensis, et Sirmiensis, cum earum suffraganeis*, Venetis: Sebastianum Coleti, 1817, f. 380.

ndryshme, me përzierje tullash, të lidhura me llaç. Mbi këtë themel ngrihej muri, i cili për aq sa ruhej, ishte ndërtuar në faqen e jashtme me material të përzier, me ripërdorim elementesh arkitektonike të periudhës së Antikitetit. Blloqet më të mëdha ishin vendosur drejtpërdrejt mbi nivelin e themelit. Këto elemente përbëheshin nga pjesë altarësh funerarë e votiv, pjesë relievesh, mbishkrimesh monumentale, fragmente sarkofagësh etj. Pjesa më e madhe e tyre ishte vendosur me pjesën e pasme të ekspozuar në ballinën e murit dhe faqen që duhej të ishte e gdhendur apo me mbishkrim në brendësi të murit. Pothuajse të gjithë i takojnë periudhës perandorake romake. Gërmimet arkeologjike të zhvilluara vetëm në linjën ballore zbuluan disa elemente arkitektonike të periudhës së Antikitetit të cilat nuk ishin përdorur nga ndërtuesit, por thjesht ishin braktisur pa ndonjë rregull të dukshëm. Më pas kishte vazhduar përdorimi i bastionit, duke i mbuluar këto objekteve me shtresa dherash. Gjatë gërmimeve arkeologjike të kryera u arrit të mblidhen mbi 25 elemente arkitektonike që përmbajnë dekore të ndryshme apo profile të punuara. Me interes për t'u përmendur është edhe dallimi në qasjen ndaj këtyre objekteve. Ndërsa kemi raste me fragmente altarësh ku mbishkrimi latin ishte fshirë tërësisht, një fragment i pjesshëm mbishkrimi monumental latin ku qartësisht dallohej treshkronjëshi AVG (ustus) ishte vendosur në një pozicion shumë të dukshëm.

Pjesa e sipërme e murit ishte ndërtuar me gurë me përmasa më të vogla dhe me përzierje më të madhe materialesh të tjera. Tullat (0.26x0.24x0.04 m) ishin përdorur për krijimin e qemerëve dhe të faqeve anësore të frëngjive. Mesi i mureve ishte i punuar me material shumë të përzier me lidhje të bollshme llaçi, kombinuar me trarë druri, nga kalbëzimi i të cilëve ishte ruajtur forma e gjurmës së tyre. Trarët, që ishin vendosur në gjerësinë e murit, u mbivendoseshin atyre që ndiqnin gjatësinë e tij. Këta të fundit ishin kuadratikë, me përmasa 0.20x0.20 m, me largësi 1.2 m nga njëri-tjetri.

Edhe ky bastion i dytë ishte i pajisur me tri frëngji në pjesën ballore dhe nga një në kënde. Duke qenë se frëngjitë e fazës pararendëse kishin përmasa më të vogla, shpatullat e tyre ishin thyer dhe zgjeruar, për t'u përshtatur me gjerësinë e frëngjive të reja. Bastioni i fazës së dytë ka pasur nivele të ndryshme përdorimi, dëshmuar nga mbivendosja e dysHEMEVE.

Se si ishte realizuar hyrja për në qytet njihet më mirë për këtë fazë. Brinja lindore e bastionit nuk lidhet me kurtinën, por krijon një hapësirë të gjerë, emërtuar si "Porta e skelës / kalasë". Porta ka pasur një

parakorridor të shkurtër, pasuar nga pragu i derës. Më tej vazhdonte një korridor i gjatë, i mbuluar. Në fundin e korridorit gjendej një oborr i hapur. Drejt krahut verior hapej një tjetër portë që lidhej me pjesën e brendshme të kështjellës. Ajo ka pasur derë dykanatëshe, me hapje nga brenda. Drejt krahut jugor hapej një derë, e cila lidhej me pjesën e brendshme të bastionit.³⁵

Ky sistem ka vazhduar të funksionojë si i tillë deri në shek. XIX. Ndryshimet në teknologjinë ushtarake si dhe ndryshimet në raportin e forcave në Mesdhe mes Perandorisë Osmane dhe fuqive europiane praktikisht kanë nxjerrë jashtë loje fortifikimet si mjeti parësor i luftimit. Në fundin e shek. XIX bastioni ka dalë jashtë përdorimit dhe mbi të është ndërtuar rezidenca (konaku) e mytesarifit osman. Gërmimet arkeologjike kanë nxjerrë në dritë disa prej themeleve të përdorura për të ndërtuar muret ndarëse të Konakut mbi perimetrin e bastionit.³⁶

Për ndërtimin e tij doli jashtë funksionit Porta e Detit në pozicionin origjinal.

Më herët kemi botuar disa dokumente të hartuara nga konsulli austro-hungarez në Durrës, i cili njoftonte Ministrinë e Jashtme të vendit të tij mbi ngjarjet në këtë qytet. Më 20 prill 1881, konsulli austro-hungarez i këtushëm njoftonte se në fundin e vitit 1880 në Durrës ishte emëruar një mytesarif dhe se tregtarët vendës duhej të jepnin një borxh prej 1 800 lirash për ndërtimin e godinës qeveritare.³⁷ Më datë 7 shtator 1881 i njëjti konsull njoftonte se tregtarët ishin tërhequr nga propozimi për të dhënë koston e ndërtimit të ndërtesës qeveritare duke bërë një propozim tjetër tregtar për financimin e saj.³⁸ Më datë 2 nëntor 1881, konsulli austriak bën me dije se ndërtimi i godinës qeveritare kishte filluar më 29 shtator 1881 dhe se punimet i drejtonte një mjeshtër nga Dibra.³⁹ Më datë 5 korrik 1882, konsulli austro-hungarez ka dërguar një

³⁵ E. Shehi, “Evoluimi i linjës juglindore të fortifikimeve të Durrësit...”, f. 91.

³⁶ Eduard Shehi, Eda Çekrezi, Ergys Hasa, Klodian Velo, Catherine Abadie-Reynal, “Rezultatet e sondazheve arkeologjike të realizuara para hyrjes së portit të Durrësit”, *Candavia*, ASA, Instituti i Arkeologjisë, Tiranë: 2017, f. 228-232.

³⁷ *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*) në *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 3-2-290. Telegram i Oculi-t në lidhje me përpjekjet e autoriteteve turke për të ngritur disa ndërtesa qeveritare në Durrës, Durrës, 20 prill 1881.

³⁸ *Po aty*, Vj. 3-4-419.

³⁹ *Po aty*, Vj. 3-2-300. Telegram i Oculi-t për ministrin, mbi kërkesën e guvernatorit osman të Durrësit për të marrë hua prej tregtarëve të qytetit, 2 nëntor 1881.

njoftim ku përmend përfundimin e ndërtesës.⁴⁰ Më 12 nëntor 1884 i njëjti konsull njofton se tregtarët e qytetit nuk kishin huazuar shumë e nevojshme për të përfunduar punimet e ndërtesës së re⁴¹. Deri në vitin 1884 ndërtesa, e cila kishte avancuar në punime, ende nuk kishte përfunduar.

Mbi linjën e mureve dhe duke përdorur konturin e bastionit u ndërtua Konaku, me tri kate dhe një kat të katërt qendror, ngritur në pjesën ballore. Ky pallat ka pasur formën e bastionit dhe ka qenë pajisur me një oborr të brendshëm. Kati përdhe ka qenë më i lartë se të tjerët, ndoshta si pasojë e ruajtjes së lartësisë së mureve fortifikuese. Ky kat ka pasur një hyrje qendrore dykanatëshe, të mbuluar me qemer, drejt së cilës ngjitej me tetë këmbë shkallë. Ballina e këtij kati nuk paraqet asnjë dritare deri në vitin 1914. Po kështu edhe faqet anësore dhe këndet e prera në 45° nuk kanë pasur dritare. Tri katet e sipërme kanë pasur nga një ballkon në ballinë. Drejt secilit prej tyre kalohej nëpërmjet një dere dykanatëshe, të mbuluar me qemer. Në të dyja krahët e dyerve të ballkoneve të katit të parë dhe të dytë hapeshin nga katër dritare, me shpatulla guri katërkëndore. Kati i tretë, me përmasa më të reduktuara, ka pasur nga një dritare në secilin krah të derës së ballkonit.⁴²

Gjetjet arkeologjike të zbuluara në punimet e Konakut dhe administrimi i tyre

Praktikat e para zyrtare të konservimit dhe administrimit të objekteve arkeologjike në Shqipëri lidhen pikërisht me fundin e shek. XIX, kur kishte filluar plotësisht funksionalizimi i sistemit muzeor të Perandorisë Osmane. Ky sistem qartësisht u ishte bërë i ditur administratorëve

⁴⁰ *Po aty*, Vj. 32-1-103. Telegram për kontin von Karolky rreth aktiviteteve ndërtuese në qytetin e Durrësit, Durrës, 5 korrik 1882.

⁴¹ Është e vështirë të kuptohet se për cilën ndërtesë bëhet fjalë. Relacioni i sipërpërmendur i referohet një kompleksi që do të ngrihej, pjesë e të cilit do të ishte edhe godina e bashkisë. Projekti i madh kapte vlerën e 300 mijë lirave dhe mosmbledhja e tyre duket se e kishte mërzitur guvernatorin, i cili në vitin 1884 i gëzohej faktit që atë vit kishte pasur një prodhim të mirë të ullinjve, me shitjen e të cilëve mund të sigurohej edhe një pjesë e shumë të nevojshme për ndërtimin e kompleksit në fjalë. Për më shumë detaje, shih Eduard Shehi, Rudenc Ruka, Eduart Caka, “Shënime mbi fortifikimet e Durrësit në periudhën osmane”, *Studime historike*, nr. 3-4, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020, f. 100.

⁴² Eduard Shehi, *Konaku i Durrësit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Botimet albanologjike, 2018, f. 146.

provincialë, për t'u pasur parasysh në detyrat që ata mbanin. Një element i tillë do të shpjegonte dokumentet e lidhura me Durrësin dhe interpretimin e tyre. Kështu, në arkivat osmanë hasim dokumente të ndryshme, të cilat na ndihmojnë të kuptojmë mënyrën se si është vepruar në ato raste kur gjendeshin objekte arkeologjike. Rasti më i hershëm i një praktike të ngjashme që kemi mundur të evidentojmë deri sot në lidhje me hapësirën e Shqipërisë në përgjithësi dhe atë të Durrësit në veçanti, ka të bëjë me punimet që u realizuan nga autoritetet osmane gjatë ndërtimit të konakut qeveritar të këtij qyteti.^{*} Mënyra se si u realizua ndërtimi i godinës është përshkruar në mënyrë të detajuar nga studimet e realizuara më herët⁴³ por, ajo çka është risi në këtë rast, ka të bëjë me faktin se gjatë punimeve për ndërtimin e objektit, këtu u gjetën disa objekte arkeologjike. Zbulimi i këtyre objekteve, të cilat duket se janë nxjerrë gjatë gjysmës së dytë të vitit 1880, përkon me kohën kur osmanët tanimë e kishin standardizuar mënyrën se si duhej të veprohej në raste të ngjashme. Kështu, sikurse mësojmë nga dokumentet e marra prej Arkivit Osman të Stambollit, menjëherë autoritetet drejtuese të sanxhakut të Durrësit ia kanë referuar çështjen qendrës së vilajetit përkatës, e cila ishte Shkodra. Ndërkohë që nga vilajeti i Shkodrës u vu në dijeni Ministria e Brendshme në lidhje me situatën.

Për t'u angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me rastin vërejmë të jetë caktuar Mustafa Beu, i cili mbante postin e kryeadjutantit në Ministrinë e Luftës. Në vijim u informua Ministria e Arsimit që kishte në varësi jo vetëm institucionet muzeore të perandorisë, por edhe administronte konservimin e objekteve arkeologjike në bazë të rregulloreve të përcaktuara prej institucionit të saj. Nisur nga dokumentet e konsultuara në lidhje me rastin në fjalë, e gjithë procedura e konservimit të këtyre objekteve në Muzeun Perandorak në Stamboll vërejmë të shtrihet në një periudhë dyvjeçare.

Mytesarifi i sanxhakut të Durrësit, Mehmet Hafiz Pasha, i dërgonte një letër Ministrisë së Brendshme, e cila daton në muajin Muharrem të vitit 1298 Hixhri (dhjetor 1880 - janar 1881) ku informon për gjetjen e

* Të tjera dokumente në lidhje me territorin e Shqipërisë janë në proces përpunimi nga ana jonë dhe do të sillen së shpejti për studiuesit.

⁴³ Për më shumë detaje në lidhje me Konakun, shih Eduard Shehi, *Konaku i Durrësit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2018; Rreth ndërtimit të objektit, gjithashtu shih E. Shehi, R. Ruka, E. Caka, "Shënime mbi fortifikimet e Durrësit...", f. 97-100.

objekteve gjatë punimeve për ndërtimin e Konakut, për lajmërimin që i kishte bërë organeve qendrore të vilajetit të Shkodrës mbi situatën dhe caktimin e kryeadjutant Mustafa Beut nga Ministria e Luftës për t'u marrë me administrimin, transportimin dhe dorëzimin e këtyre objekteve në muze.⁴⁴

Mirëpo, çfarë ishin objektet e gjetura këtu? Edhe përgjigjen e kësaj pyetjeje e mësojmë nga dokumentet e mësipërme. Kjo, për faktin se në kohën kur ishin zbuluar mbetjet arkeologjike, ishte mbajtur një procesverbal ku qe shënuar numri i sendeve të zbuluara si dhe përshkrimi fizik i tyre. Të gjitha këto i gjejmë të bashkëngjitura në listën e objekteve që Mustafa Beu ka dorëzuar në muze. Këto objekte ishin si vijon:

1. Një figurë njeriu e gdhendur mbi gur; 2. Një figurë maceje; 3. Një figurë gjeli; 4. Një figurë njeriu; 5. Një figurë luani; 6. Një figurë lepuri; 7. Një figurë njeriu; 8. Një figurë lepuri e zagari; 9. Një copë mermeri mbi të cilën ishte gdhendur një figurë vajze; 10. Një copë mermeri mbi të cilën ishte gdhendur një figurë njeriu.⁴⁵

Nëpunësi i Ministrisë së Luftës, Mustafa Beu i ka dorëzuar objektet e shënuara në listë më 22 nëntor 1882 duke na dhënë kështu edhe rastin e parë procedural të administrim-konservimit të objekteve arkeologjike që janë gjendur në hapësirën shqiptare, plot tri dekada para Shpalljes së Pavarësisë dhe krijimit të shtetit shqiptar.⁴⁶

Një detaj që mungon në këto dokumente është forma e gjetjes së objekteve të renditura: a ishin ato të vendosura në muret e bastionit dhe më pas qenë shkukur, apo ishin gjetur përgjatë hapjes së themeleve? Të dhënat nga gjurmimi arkeologjik mund të ndihmojnë në këtë drejtim. Më lart përmendëm faktin se faza e dytë e bastionit, për të cilin kemi hamendësuar ndërtimin pas vitit 1606, ishte ndërtuar duke ripërdorur shumë elemente arkitektonike të periudhës antike. Gjithashtu një numër jo i paktë elementesh të tilla ishin lënë të papërdorura në të dyja krahët e bastionit, pasi nuk kishin qenë më të nevojshme. Por gjurmimi arkeologjik nuk u shtri në të gjithë sipërfaqen që zinte bastioni/konaku, por vetëm në gjatësinë e ballinës. Për rrjedhojë, mendojmë se objektet e mësipërme arkeologjike kanë më shumë mundësi të jenë zbuluar përgjatë hapjes së

⁴⁴ Për dokumentin në fjalë, shih *Başbakanlık Osmanlı Arşivi* (më tej: BOA), MF.MKT.00078.00010.002.

⁴⁵ Për më shumë detaje në lidhje me objektet e gjetura në punimet për ndërtimin e konakut, shih *po aty*, MF.MKT.00078.00010.001.

⁴⁶ *Po aty*. MF.MKT.00078.00010.006.

themeleve të Konakut, si objekte të braktisura nga ndërtuesit e pas vitit 1606, pasi nuk ishin më të nevojshme për muret. Si të tilla, ato nuk kanë marrë mundimin t'i lëviznin prej aty por thjesht i kanë mbuluar me dhera.

Një tjetër aspekt që na tërheq vëmendjen është fakti se të dhjetë elementet e gurta të përmendura ishin të gjitha me figura njerëzore ose kafshësh. Nëse krahasojmë këtë hollësi me objektet e gjetura të braktisura përgjatë gërmimit arkeologjik (në proces studimi dhe botimi), situata qartësohet më shumë. Përgjatë gërmimit arkeologjik asnjë nga elementet arkitektonike të braktisura nuk kishte relieve me figura, por ishin kryesisht elemente arkitektonike ose fragmente mbishkrimesh. Në mure konstatuam elemente mbishkrimesh, altarësh funerarë dhe pjesë sarkofagu. Për rrjedhojë, mendojmë se përgjatë gërmimeve të realizuara për hapjen e themeleve të Konakut janë zbuluar më shumë objekte sesa përmendet në këtë dokument. Por, vëmendja e administratës osmane është përqendruar vetëm tek ato objekte që paraqisnin një vlerë ekspozimi, pasi kishin relieve me figura. Një fakt i tillë përforcohet edhe nga një element tjetër. Rruga që kalonte mbi gërmadhat e Konakut ishte shtruar me gurë të marrë nga vetë ndërtesa. Nga kontrolli që u bëmë këtyre gurëve na rezultoi se një pjesë e madhe ishin copa të thyera nga elemente arkitektonike antike, të përshtatura për ndërtim. Prandaj, me sa duket, ndërtuesit e Konakut në vitet 1880-1881, pasi kanë filluar të zbulojnë një numër jo të paktë elementesh arkitektonike të mbuluara brenda territorit të bastionit, kanë bërë një seleksionim: ato me figura janë dërguar për në Stamboll, ato me mbishkrime apo pjesë ndërtesash antike janë thyer e vendosur në muret e Konakut të ri.

Përfundime

Dokumentet osmane të marra më sipër në shqyrtim hedhin dritë mbi objektet arkeologjike që janë zbuluar gjatë fillimit të punimeve të mureve të brendshme të ndërtesës së re të Konakut në dhjetor 1880 - janar 1881, pasi si mure periferike kanë shërbyer strukturat e bastionit. Ajo çka mbetet e paqartë është së pari vendgjetja e saktë e këtyre objekteve të dërguara në Stamboll. Nuk mund të themi nëse ato janë gjetur të hedhura përgjatë gërmimeve të themeleve, si objektet e gjetura përgjatë gërmimit arkeologjik në vitin 2017, apo ishin të vendosura në murin e bastionit dhe janë shpërndarë prej aty. Si shembull për këtë version të fundit kemi përshkrimin që i bëhet Portës së Madhe të fortifikimeve osmane, cilësuar

si një muze nga prania e një numri të madh elementesh arkitektonike të hershme.⁴⁷

Rasti i Konakut të Durrësit na paraqet shembullin më të mirë të evoluimit të modeleve të qasjes së administratës osmane ndaj trashëgimisë arkeologjike. Konkretisht kemi tri modele të ndryshme vetëm në këtë ndërtesë nga vitet 1571 deri më 1880.

Në kohën e ndërtimit të fazës së parë të bastionit, afërsisht në vitin 1571, ndërtimi është bërë me material ndërtimor të përmasave të vogla, mesatare, ku të pakta ishin elementet arkitektonike antike të ripërdorura. Arsyeja mund të lidhet me financimin e paktë dedikuar ndërtimit dhe mungesën e krahut të punës, që ka ndikuar në grumbullimin e materialit të gurtë të lehtë për t'u transportuar.

Në kohën e ndërtimit të fazës së dytë të bastionit, pas vitit 1606, elementet arkeologjike antike janë grumbulluar në të gjithë qytetin që të shërbenin si material ndërtimor. Ndoshta edhe mund të jenë kthyer në gëlqere një pjesë e tyre. Kemi të bëjmë qartësisht me një investim masiv ndërtimor në funksion të mbrojtjes, i cili shpjegon përdorimin e një krahu pune aq të shumtë, sa mund të mblidhte në qytet pothuaj të gjitha blloqet e gurta kudo ku ato gjendeshin dhe të transportoheshin drejt sektorëve ku ndërtohej. Ky grumbullim e transport ishte aq i madh, sa një pjesë jo e paktë e elementeve të grumbulluara nuk kanë qenë të nevojshme për ndërtim.

Me gjithë përdorimin masiv të tyre për ndërtim dhe vendosjen me faqen e pasme të elementeve nga ballina e murit të bastionit, vihet re një element interesant që duhet përmendur. Duket se ndërtuesit kanë treguar kujdes në trajtimin e disa objekteve të veçanta. Një pjesë mbishkrimi monumental ku përmendej titulli perandorak *August* ishte vendosur qartësisht i dukshëm në bastionin e pas vitit 1606, si shpatull e një frëngjie artilerie, e dukshme si brenda edhe jashtë bastionit. Një fragment me direk anije dhe lopatë ishte vendosur i dukshëm qartësisht në ballinën e bastionit. Disa fragmente sarkofagu me gdhendje të cekët dekoruese ishin vendosur gjithashtu të dukshme, por në pjesën e brendshme të mureve të bastionit. Më pas, të tjera elemente altarësh me mbishkrime latine kishin pasur një tjetër fat. Në një rast dekori figurativ i tyre ishte ruajtur (figura të vogla lepujsh të ndërthurura me motive floreale), ndërsa

⁴⁷ Leon Heuzey, Honore Daumet, *Mission archéologique de Macédoine*, vol. II, texte et planches, Paris: Firmin-Didot, 1876.

teksti latin ishte fshirë dhe vetë objekti ishte murosur. Të tjera pjesë altarësh funerarë të thyer ishin vendosur brenda mureve si mbushës. Nuk mund të japim një shpjegim të qartë të këtyre dallimeve, vetëm nëse kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme. Ndoshta altarët me mbishkrimet e fshira ishin zbuluar shumë kohë më parë dhe kishin qenë të vendosur apo hedhur në rrugët e qytetit, ndërsa objekti me mbishkrimin monumental mund të ishte zbuluar përgjatë ndërtimit të bastionit të pas vitit 1606.⁴⁸ Janë një sërë objektesh të gurta arkeologjike të njohura nga Durrësi që kanë pasur po ashtu fate të ngjashme me ato të përmendura më lart. Bëhet fjalë për një altar funerar të periudhës perandorake romake, i cili ishte gdhendur nga faqja e tekstit latin dhe ishte ripërdorur si lug uji për kafshët pranë pusit të Top Hanes.

Një qasje tërësisht e ndryshme është ajo e viteve 1880-1881, e cila paraqet dy tipare. Objektet arkeologjike që kanë elemente artistike nxirren me kujdes, paketohen me kushte ruajtjeje, dhe më pas transportohen drejt Stambollit. Objektet pa dekore të dukshme thyhen e përdoren për ndërtimin e ri.

Së dyti, këto dokumente saktësojnë në mënyrë më të hollësishme kronologjinë e ndërtuar më parë nisur nga raportet e konsullit austro-hungarez në lidhje me ndërtimin e Konakut të Durrësit. Kështu, raportimet e konsullit austro-hungarez tregojnë se pas një sërë negociatash me tregtarët vendës ndërtimi i Konakut kishte filluar të paktën më 20 prill të vitit 1881, kurse dokumentet osmane e vendosin datën e fillimit disa muaj më parë ose në dhjetor 1880 - janar 1881. Saktësia e njohjes së fillimit të punimeve merr rëndësi të veçantë nëse konsiderohet se Konaku u ndërtua mbi murin e bastionit, duke e nxjerrë këtë të fundit dhe rrjedhimisht fortifikimet e Durrësit jashtë funksionit të tyre fillestar. Kjo datë duhet konsideruar si fillimi i fundit të një procesi të natyrshëm, ku fortifikimet mesjetare kishin filluar të dilnin jashtë përdorimit në përgjithësi për ushtritë konvencionale. Ky proces sigurisht kishte filluar shumë herët në qendrën e perandorisë me daljen nga përdorimi të Top Kapisë dhe ndërtimin e pallatit të Dollma Bahçes në vend të hapur pranë Bosforit. Ky pallat i ri, i pafortifikuar dhe i ndërtuar sipas modeleve perëndimore me siguri ka krijuar një etalon të ri për të

⁴⁸ Kujtojmë se në pjesën e pasme të bastionit osman ka qenë ndërtuar një monument publik në fundin e shek. I p.e.s. - fillimi shek. I e.s., ndoshta një stoa. Mundet që ky mbishkrim të ishte i lidhur me këtë ndërtim.

gjithë perandorinë ashtu sikurse edhe në rastin e Konakut të Durrësit. Në vazhdim, data e nisjes së punimeve për ndërtimin e Konakut solli edhe zhvlehtësimin e mënyrës së hyrjes në qytet nga e ana e detit. Kështu Porta e Detit, e mbrojtur mirë nga bastioni i mëhershëm, duhej t'i linte vendin një porte të re monumentale. Kjo portë e re, nisur edhe nga një sërë pamjesh fotografike, u zhvendos në krah të Konakut dhe u kthye në një emblemë të Durrësit të vonë osman. Ajo tashmë kishte më shumë një vlerë simbolike prestigji sesa funksion mbrojtës, edhe pse ajo bashkë me pjesën tjetër të fortifikimeve u sprovuan dhe një herë të fundit gjatë Luftës së Parë Botërore.

Në përfundim, dokumentet në fjalë na japin një panoramë të parë dhe të panjohur deri më sot mbi qasjen zyrtare e të kujdesshme ndaj objekteve arkeologjike në Durrës dhe Shqipëri. Në të ardhmen e afërt synojmë që të botojmë një numër më të madh dokumentesh të ngjashme nga i gjithë territori i Shqipërisë, që do të mund të na ofrojnë një pamje më të plotë mbi fillesat e gërmimeve të para të arkeologjisë së shpëtimit në Shqipëri. Në këtë formë shikojmë se numri i objekteve arkeologjike të gjetura ndër shekuj në Shqipëri dhe të dërguara në Stamboll është shumë më i madh nga sa është njohur deri më sot. Në bibliografinë tonë përmenden kryesisht dy gjetje, thesari i Vrapit i ndarë në tre muze të ndryshëm⁴⁹ dhe sarkofagu me dekor në relief, njohur si Sarkofagu i

⁴⁹ Bëhet fjalë për 41 objekte prej të cilave 39 ruhen në “Metropolitan Museum of Art”, New York, një në “Muzeu Arkeologjik” të Stambollit, një në “Walters Art Gallery”, Baltimore. D. Piguët-Panauotova, “The Gold and Silver Vessels from the Albanian Treasure in a new light”, në R. Harreither, Ph. Pergola, R. Pilliger, A.Pülz (bot.) *Akten des XIV. Internationalen Congresses für Christliche Archäologie*, Wien 19.-26.9.1999. Frühes Christentum Zwischen Rom und Konstantinopel, teil I, Österreichische Akademie der Wissenschaften, Wien: 2006, f. 608. Një pjesë e tyre u blenë nga konsulli austriak në Durrës, Rémi de Kwiatkowski, mes viteve 1902 dhe 1907. Në vitin 1911 ai u transferua në Romë dhe i shiti objektet të J. Pierpont Morgan. Shih Éva Garam, “The Vrap Treasure”, në Katherine R. Brown, Dafydd Kidd, Charles T. Little (bot.), *From Attila to Charlemagne. Arts of the Early Medieval Period in The Metropolitan Museum of Art*, The Metropolitan Museum of Art/Yale University Press, 2000, f. 170.

Mbi të ka ende paqartësi dhe ngatërresa në datat e vendin e gjetjes. Në vitin 1901 në Vrap, sipas É. Garam, “The Vrap Treasure ...”, f. 170, dhe gabimisht, po në të njëjtin libër, në vitin 1894 në Ersekë, sipas Csánad Bálint, “Some Avar and Balkan Connections of the Vrap Treasure”, në K.R.Bwron, D.Kidd, C.T.Little (bot.), *From Attila to Charlemagne. Arts of the Early Medieval Period in The Metropolitan Museum of Art*,, f. 179.

Meleagrit ekspozuar në Stamboll. Një tjetër objekt i papërmendur në bibliografinë shqiptare është një mbishkrim shumëvradhësh në greqishten mesjetare që lidhet me fortifikimet e Durrësit, i cili ruhet në Stamboll pa të dhëna mbi vendgjetjen e tij.⁵⁰ Fakti që mbishkrimi i dedikohet fortifikimeve të Durrësit tregon edhe origjinën e tij. Tashmë me këtë dokument të ri mund të shtojmë një numër të konsiderueshëm objektesh të trashëgimisë sonë arkeologjike, të cilat duhet të identifikohen, studiohen e datohen. Të tjera do t'i shtohen në vazhdim kësaj liste në botimet tona të ardhshme.

S u m m a r y

THE BEGINNINGS OF THE RESCUE ARCHAEOLOGY IN ALBANIA FROM THE PERSPECTIVE OF OFFICIAL OTTOMAN RECORDS: THE CASE OF DURRËS GOVERNMENT OFFICE

This article aims to present the official approach of the Ottoman state regarding the archaeological objects found in the excavations that took place in several areas of the empire during the second half of the nineteenth century. The new records found in the Turkish archives regarding the topic provide to us a different view regarding the rescue and the preservation of the archaeological finds by the Ottoman state. The traditional Albanian bibliographical data on the related topic records only two examples of archaeological artifacts discovered in this area that were transported and deposited in the Imperial Museum in Istanbul. This article enriches the list of the objects found in Albania and preserved in the imperial capital but also provides a concrete understanding on how the state officials operated in such cases. The article provides new and important information from an administrative perspective on the history of the Albanian archaeology as well as a case study that could further assist similar studies for other parts of the Ottoman Empire.


⁵⁰ Cyril Mango, "A Byzantine Inscription relating to Dyrrhachium", *Archäologischer Anzeiger* 3, Deutsches Archäologisches Deutsches Archäologisches Institut, Berlin, New York: 1966, f. 410-414.

Faksimilet


شماره	توضیح	تاریخ	محل
۱	کتابخانه خاندان عثمانی -		
۱	کتابخانه عثمانی -		
۲	کتابخانه عثمانی -		
۳	کتابخانه عثمانی -		
۴	کتابخانه عثمانی -		
۵	کتابخانه عثمانی -		
۶	کتابخانه عثمانی -		
۷	کتابخانه عثمانی -		
۸	کتابخانه عثمانی -		
۹	کتابخانه عثمانی -		
۱۰	کتابخانه عثمانی -		

OSMANLI ARŞIVI		
MF.MKT		
78	10	1

Dok. 1, Lista e objekteve të gjetura



Dok. 2, Letër e hafiz Mehmet Pashës drejtuar Ministrisë së Brendshme



Dok. 3, Shkresë që vërteton dorëzimin e objekteve në fjalë në Muzeun Perandorak prej Mustafa Beut